



Mbi 300 dibranë të gjeneratës së tretë jetojnë të vetmuar

Shtëpia e pleqve është nevojë

Kryetari i Kuvendit të LSHPM Besnik Pocesta thotë se hapja e shtëpisë së pleqve është nevojë e kohës në të cilën jetojmë. Për shkak të kësaj gjendje kërkohet urgjentisht zgjidhje që me qëllim kjo kategori e personave të jetojnë qetë dhe rehatshëm



Pleqëria në Dibër për shkak të migrimit të fuqishëm të rinisë krijon probleme në lidhje me jetën e të moshuarve. Nga dita në ditë rritet numri i personave të gjeneratës së tretë të cilët jetojnë të vetmuar. Është numri i madh i të moshuarve të cilët në qytete dhe fshatra jetojnë të vetmuar, ndërsa sipas Shoqatës së pensionistëve Dibër dhe Qendra Zhupë ai numër është rreth 300. Për shkak të kësaj gjendje kërkohet urgjentisht zgjidhje që me qëllim kjo kategori e personave të jetojnë qetë dhe rehatshëm. Për shkak të gjendjes së theksuar institucionet, por edhe familjet, kërkohet themelimin e një shtëpie të pleqve. Nevoja e një shtëpie të pleqve në Dibër është debatuar në mbledhjet e shumë institucioneve duke filluar nga pushteti lokal e deri tek shoqata e pensionistëve. Të gjitha vlerësimet janë se është i domosdoshëm themelimi i një shtëpie për pleq ku do të vendoseshin

pleqtë dhe personat që kanë nevojë për përkujdesje, të cilët jetojnë vetëm dhe pa përkujdesje. Kryetari i Kuvendit të LSHPM Besnik Pocesta thotë se hapja e shtëpisë së pleqve është nevojë e kohës në të cilën jetojmë.

Sipas Pocestës, për hapjen e një shtëpie të pleqve është biseduar edhe me Ministrin e punës dhe politikës sociale të RM, Dime Spasov.

“Për momentin, pasi që ende bëhen bisedimet, ka edhe variant që personat e moshuar nga Dibra të vendosen në shtëpinë rajonale të pleqve në Ohër, e cila do të ndërtohet në Ohër. Dibranët në asnjë mënyrë nuk heqin dorë nga ndërtimi i një institucioni të këtyllë në Dibër, posaçërisht që për ndërtimin e një objekti të këtyllë që do të jetë i dedikuar për shtëpi të pleqve, ka edhe iniciativa private nga mërgimtarët tanë nga SHBA, të cilët kërkohet të përfshihen në investimin e një objekti të këtyllë të do-

mosdoshëm. Informatat thonë se së paku katër biznesmenë me prejardhje nga Dibra në SHBA kanë kërkuar informacione nga institucionet kompetente për ndërtimin e një shtëpie të pleqve në Dibër. Ata konsiderojnë se efektet do të ishin të dyfishta. Nga njëra anë definitivisht pleqtë e vetmuar nuk do të mbeten vetëm dhe se do të kujdesen në institucion, ndërsa nga ana tjetër efekt material do të kenë edhe investitorët.

Në një situatë kur një pjesë e pleqve nuk kanë afër vetes persona të familjes së tyre ose ndonjë të afërm dhe miq, ndërtimi i shtëpisë është i domosdoshëm edhe kundrejt asaj që në Dibër tradita është që pleqtë të mos lejohen të jetojnë vetëm. Tani si duket ka kaluar “koha e turpit” pleqtë të vendosen në Shtëpi për pleq, sepse nuk ka rrugëdalje tjetër”, thotë Pocesta.

Me këtë konstatim pajtohen edhe të moshuarit edhe të rinjtë në Dibër dhe

rrethinë. Për ndryshe, është fakt që në Dibër ka shoqata të cilat u ndihmojnë pleqve të vetmuar dhe personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, Kryqi i Kuq ka projekte të shumta për ndihmë të pleqve, por megjithatë ajo nuk është njëjtë.

“Ndërtimi i shtëpisë së pleqve nuk do të ndërprejë projektet e këtylla. Ato do të vazhdojnë, ndërsa do të ketë edhe të tjera. Interesimi që ti ndihmohet kësaj kategorie të personave tek vullnetarët e organizatës është i madh, por njerëzit gjenden edhe me mënyra të tjera. Disa nga personat e moshuar me mbështetje financiare të fëmijëve të tyre që janë jashtë vendit, paguajnë edhe persona të tretë që u ndihmojnë në përditshmëri dhe kujdesen që pleqtë të kenë përkujdesje të mirë dhe të mos kenë probleme. Gjithashtu, ka edhe një fenomen interesant posaçërisht në vendbanimet rurale ku grupet e personave të moshuar që tu jetë më lehtë gjatë ditës, jetojnë së bashku tek një prej pleqve. Ata së bashku përgatisin ushqimin edhe kanë komunikim më të mirë ditor. Nuk ndihen të vetmuar dhe më mirë ndihen së bashku. Megjithatë, gjendja në të cilën gjenden mbi 300 të moshuar në Dibër dhe fshatra, kërkohet zgjidhje të shpejtë. Të problemit”, thotë sekretari i organizatës komunale të Kryqit të Kuq, Isni Telqiu.



Në Çair shoqërim me lojëra sportive

Në organizim të LSHPM më 21 maj të 2016 në shkollën fillore “Rajko Zhinzifov” u mbajtën Garat e 21-ta sportive rajonale të pensionistëve të rajonit të parë. SHP Çair ishte nikoqiri i suksesshëm, ndërsa në gara morën pjesë pensionistë sportistë nga SHP Qendër, SHP Kisella Vodë, SHP Solidarnost – Aerodrom, SHP Gazi Babë, SHP Butel, SHP Shuto Orizarë, SHP “Solidarni penzioneri” nga Ilinden dhe Shoqata e pensionistëve të luftës. Para në numri të madh të pensionistëve dhe qytetarëve, adhures të sportit, 350 pjesëmarrës kanë matur forcat dhe kanë shfaqur gatishmëri të mirë fizike në 11 disiplina sportive, në konkurrencë për meshkuj dhe femra. Në hapjen solemne të garave, fillimisht të pranishmit, në gjuhën maqedonase dhe shqipe i përshëndeti nikoqiri i këtyre lojërave dhe kryetari i KE të SHP Çair, Mentor Qoku, i cili u dëshiroi mirëseardhje, gara të drejta, fat sportiv dhe argëtim të mirë. Me fjalë rasti në gjuhën maqedonase dhe shqipe, për rëndësinë e këtij manifestimi sportiv të pranishmëve dhe pensionistëve sportistë iu drejtua edhe kryetari i Kuvendit të LSHPM, Besnik Pocesta, i cili mes tjerash tha: “LSHPM manifestimet e këtylla sportive i organizon, mbështet dhe i ndihmon, sepse kanë masivitet, frymë sportive dhe karakter multietnik. Në këto gara bëjmë sport dhe shoqërohem”. Sukses dhe mbështetje garuesve, në gjuhën maqedonase dhe shqipe, u dëshiroi edhe kryetari i Këshillit të Komunës Çair, Zahir Bekteshi, i cili fillimisht i dërgoi përshëndetjet e kryetarit të Komunës Zet Mexhiti, ndërsa pastaj tha: “Kemi bashkëpunim të mirë me shoqatën e pensionistëve dhe më tutje si deri më tani do të mbështesim aktivitetet dhe manifestimet e tyre në kufijtë e mundësive tona”, theksoi në fjalimin e tij Zahir Bekteshi dhe garat i shpalli si të hapura. Më pastaj filluan garat, në të cilat rezultatet më të mira arritën sportistët nga SHP Gazi Babë, me 6 vende të para. Garuesit e SHP Qendër fituan 5 vende të para, SHP Solidarnost – Aerodrom dhe SHP “Solidarni penzioneri” – Ilinden nga 4, SHP Çair 2, ndërsa SHP Butel dhe SHP Kisella Vodë nga 1 vend të parë. Manifestimi sportiv, i cili ishte një prej më të mirë të organizuara, përfundoi me ndarjen e diplomave për fituesit, ndërsa shoqërimi përfundoi me argëtim të përbashkët ku këndohej, vallëzohej në restorantin “Festina”.

Dy ekskursionet të pensionistëve të Sarajit

Shoqata e pensionistëve të komunës Saraj, në kuadër të aktiviteteve programore, organizoi dhe realizoi dy ekskursionet njëditore, një në Prizren dhe Gjakovë të Kosovës, ndërkaq tjetrin në Shën

Naum të Maqedonisë dhe në Pogradec të Shqipërisë. Në të parin morën pjesë 175 pensionistë të shoqatës në fjalë, ndërkaq në të dytin kanë marrë pjesë 109 pensionistë. Në Prizren dhe në Pogradec u vizituan monu-


mente kulturore – historike. Në ekskursionin e dytë në Shën Naum dhe Pogradec, kanë marrë pjesë edhe pensionistët nga Aktivi i grave pranë shoqatës në krye me kryetaren Zulfie Ramadani. Interesimi i pensionistëve

për ekskursionet është shumë i madh sa që shoqata e ka vështirë të refuzoj ndonjë. Pensionistët mbeten të kënaqur nga ekskursionet. Mbeten në pritje edhe të ekskursioneve tjera.

Shaban Azizi e bën të rrezatojë shoqata e pensionistëve

Energjik edhe si pensionist

I lindur me 1.10.1937 në fshatin Bogovinë të Tetovës, në një familje atdhetare, ku edhe mori mësimet e para për të nisur jetën si fëmijë e duke u shkolluar aso kohe në kushtet dhe rrethanat që nuk ishin të favorshme, veçmas për shqiptarët. Me të arritur kualifikimin e duhur, u inkuadrua në shkollën e fshatit për të punuar në administratën shkollore, ku edhe i kaloi plotë 40 vite



Gjatë gjithë asaj periudhe z. Azizi u dëshmuar me angazhimin e tij duke i dhënë frymë e rrezatim punës dhe aktiviteteve me të cilat u mishërua gjatë gjithë asaj periudhe. Pasi përfundoi shekullin e punës së rregullt, Shaban Azizi, ende me plotë energji fizike e intelektuale, nuk deshi të pasivizohet, përkundrazi ai u përfshi në organizimet e shumta të Shoqatës së pensionistëve të Tetovës. Azizi shumë shpejtë u gjend në sektorët e kësaj shoqate, duke u dëshmuar me aktivitetin dhe performansën e veprimit si pensionist. Me kalimin e viteve, Azizi zgjidhet Kryetar i Shoqatës së pensionistëve të Tetovës, shoqatë kjo e cila numëron afro 12 mijë anëtarë të rregullt. Si prijës i kësaj Shoqate, inicioi shumë aktivitete, të cilat implementoheshin nëpërmjet Komisioneve dhe trupave punues të këtij organizimi pensional. I gjithë aktiviteti i tij në bashkëpunim me

stafin udhëheqës në vijimësi ka qenë i orjentuar në ofrimin e shërbimeve të llojllojshme për pensionistët, në mënyrë që jeta e kësaj kategorie të njerëzve të bëhet më e lehtë. Në këtë plan vlen të theksohen disa nga aktivitetet që i ka mbështetur z. Azizi. Pensionistët janë të organizuar në klubet e tyre në rajonet ku edhe jetojnë. Në ato klube zhvillohen një mori aktivitete, të cilat koordinohen me udhëheqësinë e Shoqatës. Mbledhjet e pensionistëve në klube janë të rregullta, kurse vendimet që merren i dorëzohen Shoqatës në qendër, ku edhe bëhet analiza e tyre, inkorporohen idetë

dhe iniciativat në Programe dhe Raporte. Brenda Shoqatës së pensionistëve të Tetovës funksionojnë disa Komisione dhe trupa punues, në kuadër të të cilave trajtohen çështje nga sfera e Shëndetësisë, kulturës, sportit, çështje statutare-juridike, etj. Të gjitha ato Komisione koordinohen nga ana e Këshillit ekzekutiv të Shoqatës të udhëhequr pikërisht nga Shaban Azizi. Një aktivitet tjetër tejet i rëndësishëm i Shoqatës është edhe ndarja e ndihmave financiare dhe ndihmave të tjera për pensionistë të cilët janë me të hyra të ulta, përkatësisht pensionistë të cilët vuajnë nga

sëmundje kronike. Ky aktivitet zhvillohet dy herë brenda vitit, duke u ndarë mjete sipas vendimit me kritere pensionistëve të cilët vërtetë kanë nevojë për t.i mbështetur. Vlen të theksohen edhe aktivitetet sportive. Brenda vitit organizohen gara sportive të nivelit rajonal dhe republikan, në të cilat gara Shoqata e Tetovës vite me radhë radhitet në vendin e parë. Sukseset e shoqatës në shumë disiplina sportive varen shumë nga furnizimi i skuadrave me rekuizita sportive dhe pajisje të tjera të nevojshme, ndihmë kjo e cila nuk kursëhet asnjëherë nga Kryetari i Shoqatës,

Shaban Azizi. Segment i rëndësishëm i veprimit pensional është edhe pjesëmarrja e anëtarëve të kësaj shoqate në revy të organizuara nga Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, në të cilat manifestime, grupi i folkloristëve tetovar (shqiptar e maqedonas) me programet e tyre prezantohen në qytete të ndryshme në vend, mbase edhe në shtete të tjera. Aktualisht Kryetari është duke e realizuar mandatin e dytë në krye të këtij organizimi pensional, asociacion ky i cili përveç tjerash ka krijuar një atmosferë të vërtetë miqësie në mesin e moshës së tretë, pa marrë

parasysh përkatësitë kombëtare, fetare, gjinore etj. Ai zotohet se deri në fund të këtij mandati do t'i realizojë me përpikshmëri të gjitha aktivitetet që për bazë kanë Vendimet e miratuara në Këshillin ekzekutiv dhe në organet tjera të shoqatës. Nën udhëheqjen e z. Azizi, Shoqata e pensionistëve tetovar do të jetë një organizim i personave të moshuar, model për të gjitha organizimet tjera që bëhen në shoqata dhe asociacione të ndryshme. Zaten në këtë mënyrë pensionistët arrijnë t'u ikin ca preokupimeve moshore, duke e bërë jetën më aktive dhe të ngjeshur me aktivitete.